



# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Qershor



03

## BASHKËPUNIMI ME KOMISIONERIN E BE-SË PËR RININË, Z.GLENN MICALLEF PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE PËR TË RINJTË

Në mjediset e Shkollës Profesionale "Gjergji Canco" u zhvillua një takim informues me përfaqësues të nivelit të lartë mbi promovimin e Garancisë Rinore dhe politikave rinore që synojnë fuqizimin e të rinjve në Shqipëri. Në takim morën pjesë Komisioneri i BE-së për Rininë, z. Glenn Micallef, Ministria Bora Muzhaqi, Zëvendësministria Olta Manjani dhe përfaqësues nga BE, UNDP dhe UNICEF.

Ministria Muzhaqi theksoi se zbatimi i programit të Garancisë Rinore do të mbështetet fuqimisht nga 61 Këshillat Vendorë Rinorë dhe Këshilli Kombëtar Rinor, si mekanizma që përfaqësojnë zërin e të rinjve në vendimmarrje. Programi ofron mundësi për trajnim, edukim apo punësim brenda 4 muajve nga regjistrimi, dhe deri më tani është pilotuar me sukses në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë me 1,082 përfitues. Në fazën e ardhshme ky program do të shtrihet në nivel kombëtar.

Në kuadër të rritjes së mundësive për të rinjtë, Ministria prezantoi edhe dy programe mbështetëse: Talentet Rinore, që mbështet financimin për pjesëmarrjen e të rinjve të talentuar në konkurse ndërkombëtare dhe mbështetjen për projekt-idetë e grupeve rinore joformale, nëpërmjet Nismave Komunitare. Takimi u shoqërua nga diskutime të hapura me të rinj përfitues të programeve dhe përfaqësues të institucioneve, duke ndarë ide, përvoja dhe pritshmëritë për të ardhmen.



04

## #UNI DEBATE – FUQIA E TË RINJVE NIS ME FJALËN, VAZHDON ME VEPRIMIN!

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe në bashkëpunim me kompaninë Titan Albania, mbështeti financiarisht zhvillimin e Konkursit Kombëtar të Debatit "UNI Debate", organizuar nga organizata Liburnetik. Aktiviteti përfshiu rreth 160 studentë të moshës 18-26 vjeç nga 7 universitete, të angazhuar në debate publike me qëllim nxitjen e mendimit kritik dhe pjesëmarrjes aktive në shoqëri.

Ministria Bora Muzhaqi, e cila ndoqi nga afër aktivitetin përmblylës të konkursit, vlerësoi të gjithë pjesëmarrësit si fitues, duke theksuar se "përmes kësaj platforme kombëtare, të rinjtë fuqizohen me mendim kritik, komunikim të strukturuar dhe përfshirje në debate dhe tema të rëndësishme që zhvillojnë shoqërinë". Vendi i parë e fitoi skuadra e Universitetit "Ismail Qemali", ndërsa vendi i dytë shkoi për Universitetin e Tiranës. "UNI Debate" është një tjetër shembull konkret se rinia shqiptare është e gatshme të marrë pjesë aktive në vendimmarrje dhe të udhëheqë me ide



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
KRYEMINISTRIA  
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT



# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Qershor



05

## BIZZTOWN – QYTETI I VOGËL QË FORMON QYTETARË TË MËDHENJ!

Ministrja për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, mori pjesë në "Bizztown", një projekt inovativ i Junior Achievement, mbështetur nga AADF, që çdo vit sjell risi në edukimin financiar të fëmijëve. Pika kulmore e këtij programi që zhvillohet në 5 shkolla, ishte aktiviteti i zhvilluar pranë mediseve të Piramidës, ku fëmijët e klasave të pesta ndërtuan një qytet të improvizuar me banka, zyra punësimi, kompani teknologjie e ndërtimi, zyra mediatike dhe madje edhe zgjedhje për të ardhmen e qytetit të tyre.

Ministrja theksoi se edukimi financiar mësohet më mirë nëpërmjet praktikës, dhe se fëmijët treguan se janë më se gati për sfidat e së nesërme. "Nuk duhet të kemi frikë nga risia, përkundrazi, duhet ta përqafojmë dhe ta kthejmë në një avantazh për fëmijët tanë, për t'i rritur të përgatitur, të pavarur dhe me mendësi sipërmarrëse," u shpreh ajo. Ky ishte një shembull frymëzues se si edukimi praktik u jep fëmijëve besimin për të ndërtuar të ardhmen me mendje të hapur dhe zemër sipërmarrëse.



06

## "WE ARE ALL MADE OF STARS 3" – NJË MBRËMJE FRYMËZIMI DHE TALENTI RINOR

Rreth 2000 të rinj nga 7 bashki të vendit u bënë pjesë e projektit "We Are All Made of Stars 3", mbështetur nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe organizuar nga Qendra Multifunkionale SWANS. Mbrëmja Gala e zhvilluar në Teatrin e Operas dhe Baletit ishte një platformë gjithëpërfshirëse ku të rinjtë performuan në zhanre të ndryshme si aktrim, kanto, balet dhe instrumenta, duke promovuar barazinë, talentin dhe përfshirjen sociale përmes artit. Të rinjtë u vlerësuan me çmime të ndara nga figura të njohura të artit dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, duke e kthyer këtë aktivitet në një festë të vërtetë talenti dhe frymëzimi rinor.



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
KRYEMINISTRIA  
MINISTRIA E SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Qershor



07

#JUNIORMINISTER – KUR TË RINJTË PROVOJNË LIDERSHIPIN NGA AFËR

Në kuadër të 1 Qershorit, u zhvillua edicioni i përvitshëm i iniciativës "Junior Minister", një nismë frymëzuese e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Kaltra, e përzgjedhur si Ministre për një Ditë, ndoqi nga afër ministres Bora Muzhaqi të gjithë axhendën ditore të angazhimeve zyrtare. Kjo nismë simbolike, që rikthehet çdo vit, u jep të rinjve një mundësi të veçantë për të njohur nga brenda proceset e punës institucionale dhe për t'u motivuar drejt përfshirjes aktive në shoqëri dhe vendimarrje.



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
KRYEMINISTRIA  
MINISTRIA E SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT